



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 268 Akti

Nr. 421 Vendimi
Tiranë, më 13.7.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bekteshi	Kryesuese
Etleda Çiftja	Anëtare
Olsi Komici	Relator

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar z. Ferdinando Buatier de Mongeot, në datën 13.7.2021, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Anila Galanxhi (Pappa)**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;

Vendimi nr.78, datë 12.12.2017 i Gjykatës Kushtetuese.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

- 1.** Subjekti i rivlerësimit, znj. Anila Galanxhi (Pappa), gjatë periudhës së rivlerësimit kalimtar ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në zbatim të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
- 2.** Komisioni i Pavarur i Kualifikimit më 15.1.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, zhvilloi procedurat e shpërndarjes së çështjeve me short, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Anila Galanxhi, do t’i nënshtrohej procesit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Brunilda Bekteshi, Firdes Shuli dhe Olsi Komici. Relator i çështjes me short u zgjodh komisioneri Olsi Komici.
- 3.** Më 16.1.2019 anëtarja e trupit gjykues, Firdes Shuli, paraqiti kërkesë për dorëheqje nga gjykimi i kësaj çështjeje, për shkak të lidhjeve familjare me subjektin e rivlerësimit Anila Galanxhi.
- 4.** Komisioni, me vendimin e datës 18.1.2019, miratoi kërkesën për dorëheqje të znj. Firdes Shuli, nga gjykimi i kësaj çështjeje, duke u caktuar si anëtare trupe komisionerja zëvendësuese Etleda Çiftja.
- 5.** Menjëherë pas hedhjes së shortit, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u administruan raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK).
- 6.** Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin e datës 15.1.2019 vendosi fillimin e hetimit administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme, për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues komisioneren Brunilda Bekteshi. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.
- 7.** Në datën 29.1.2019, subjekti i rivlerësimit, u njoftua nëpërmjet postës elektronike, mbi fillimin e procesit të rivlerësimit kalimtar, përbërjen e trupit gjykues dhe iu kërkua të shprehej nëse ishte në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e tij.
- 8.** Në datën 4.2.2019, subjekti i rivlerësimit i njoftoi Komisionit në rrugë elektronike kërkesën për përjashtimin e anëtarit të trupit gjykues, znj. Etleda Çiftja, pasi ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit¹.
- 9.** Komisioni, me vendimin e datës 21.4.2020, njoftuar subjektin me e-mailin e datës 27.4.2020, ka vendosur mospranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për përjashtimin e anëtarit të trupit gjykues Etleda Çiftja.

¹ Anëtari Etleda Çiftja ka qenë pjesë e trupit gjykues në procesin e hetimit administrativ të një subjekti tjetër rivlerësimi, z. Alaudin Malaj, që është kunati i subjektit.

10. Trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, me vendimin e datës 9.4.2021, vendosi të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit për kriterin e pasurisë dhe figurës dhe, po në datën 9.4.2021, subjekti u njoftua në rrugë elektronike për rezultatet e hetimit dhe të drejtën për t'u njohur me dokumentacionin e dosjes, kthimin e përgjigjeve dhe depozitimin e provave brenda datës 26.4.2021, ora 16:00.

11. Në datën 22.4.2021 subjekti i rivlerësimit njoftoi Komisionin në rrugë elektronike se kërkonte kohë shtesë mbi një muaj për kthimin e përgjigjeve të rezultateve të hetimit dhe depozitimin e provave.

12. Në datën 23.4.2021 subjekti i rivlerësimit u njoftua nga Komisioni në rrugë elektronike për shtyrjen e afatit të kthimit të përgjigjeve deri më 10.5.2021, si afat më se i mjaftueshëm për përgatitjen e shpjegimeve dhe mbledhjen e provave.

13. Në datën 7.5.2021 subjekti i rivlerësimit njoftoi Komisionin se ka paraqitur disa kërkesa të reja për marrje dokumentacioni të nevojshëm për kthimin e përgjigjeve, lidhur me barrën e provës të dërguar nga Komisioni.

14. Në datën 10.5.2021 Komisioni njoftoi subjektin në rrugë elektronike se vendosi t'i japë kohë shtesë deri më 17.5.2021, afat ky që konsiderohet më se i mjaftueshëm për t'i kthyer përgjigje Komisionit, pasi kërkesat e reja të bëra nga subjekti janë trajtuar në vazhdimësi gjatë hetimit dhe korrespondencës me subjektin për më shumë se 2 vjet.

15. Në datën 17.5.2021 subjekti i rivlerësimit i dërgoi Komisionit me rrugë elektronike "observacionet" për të vërtetuar të kundërtën e barrës së provës, si dhe paraqiti kërkesën për çeljen e hetimit administrativ për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.

16. Në datën 18.5.2021 Komisioni vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, e cila do të zhvillohej më 21.5.2021, ora 14:30.

17. Në datën 20.5.2021 subjekti i rivlerësimit njoftoi Komisionin në rrugë elektronike lidhur me pamundësinë për t'u paraqitur në seancë dëgjimore të nesërmen e datës 21.5.2021, për faktin se ishte diagnostikuar me Covid-19 dhe kërkoi shtyrjen e seancës.

18. Komisioni, me anë të postës elektronike, më 24.5.2021, ka njoftuar subjektin se për shkak të situatës së saj shëndetësore, seanca dëgjimore e planifikuar në datën 21.5.2021, do të shtyhej në datën 7.6.2021, ora 9:45.

20. Subjekti i rivlerësimit në datën 1.6.2021 ka depozituar pranë zyrës së protokollit të Komisionit kërkesën për miratimin e dorëheqjes, protokolluar me nr. ***, drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë (në vijim KLP), anëtarëve të KLP-së dhe për dijeni Komisionit, me anë të së cilës kërkohet miratimi i dorëheqjes nga detyra e prokurorit.

21. Subjekti i rivlerësimit, më 3.6.2021, me anë të postës elektronike, i ka kërkuar Komisionit të bëjë pezullimin e procesit të rivlerësimit dhe shtyrjen e seancës dëgjimore, pasi ka paraqitur pranë KLP-së më 1.6.2021 kërkesën për dorëheqje nga detyra si prokurore dhe mbarimin e statusit të magjistratit.

22. Komisioni, po në datën 3.6.2021, me anë të postës elektronike, ka njoftuar subjektin e rivlerësimit mbi marrjen e kërkesës së saj për dorëheqje nga statusi i magjistratit dhe se për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit duhet të ezaurohen hapat: **a)** marrjen formë të prerë të

vendimit të KLP-së; **b)** pas konfirmimit të marrjes së formës së prerë të vendimit, Komisioni procedon me ftesën e subjektit për në seancën dëgjimore, në mënyrë që të deklarojë dorëheqjen ose deklarin e tij me anë të postës elektronike, se nuk do të dëshironte të merrte pjesë në seancë dëgjimore, pasi të jetë shprehur vullneti i pavesuar për dorëheqje nga procesi i rivlerësimit dhe **c)** pasi të ezaurohen dy hapat më lart, trupi gjykues merr vendimin për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit.

23. KLP-ja, me shkresën “Dërgohet vendimi nr. *** i KLP-së” të datës 22.6.2021² protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 22.6.2021, njoftoi deklarin e mbarimit të statusit për shkak dorëheqjeje të subjektit Anila Galanxhi (Pappa), duke bashkëngjitur edhe vendimin nr. ***, datë 18.6.2021.

24. Me vendimin nr. ***, datë 18.6.2021, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, ka vendosur: **(1)** deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit për shkak dorëheqjeje për znj. Anila Galanxhi (Pappa), me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë; **(2)** dorëheqja jep efekt më 31.7.2021; **(3)** të njoftohen për këtë vendim znj. Anila Galanxhi (Pappa), Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit; **(4)** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

25. Komisioni, me shkresën e datës 2.7.2021³ ka kërkuar informacion nga Gjykata Administrative e Apelit nëse ndaj vendimi të KLP-së nr. ***, datë 18.6.2021 është ushtruar ankim nga subjekti i rivlerësimit Anila Galanxhi (Pappa).

26. Gjykata e Administrative e Apelit Tiranë, me shkresën e datës 7.7.2021⁴, ka konfirmuar se deri më 6.7.2021 nuk është bërë ankim ndaj vendimit të KLP-së nr. ***, datë 18.6.2021, nga subjekti i rivlerësimit Anila Galanxhi (Pappa).

27. Komisioni, me shkresën e datës 2.7.2021⁵ ka kërkuar nga KLP-ja të konfirmojë nëse nga ana e subjektit të rivlerësimit është bërë ankim ndaj vendimit nr. ***, datë 18.6.2021 dhe nëse ky vendim ka marrë formë të prerë.

28. KLP-ja, me shkresën e datës 8.7.2021⁶ ka informuar se vendimi i saj nr. *** prot., datë 18.6.2021, ka hyrë në fuqi menjëherë dhe dorëheqja i fillon efektet më 31.7.2021. Pas verifikimit të kryer në zyrën e protokollit nuk rezultoi që deri më 8.7.2021, subjekti të kishte paraqitur ankim ndaj këtij vendimi.

II. ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

29. Procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit ka filluar në respektim të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 4 të nenit 4 të ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

30. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara më lart, konstaton se:

² Shkresa e KLP-së me nr. *** prot., datë 22.6.2021.

³ Shkresa e Komisionit nr. *** prot., datë 2.7.2021.

⁴ Shkresa e Gjykatës Administrative të Apelit nr. *** prot., datë 7.7.2021.

⁵ Shkresa e Komisionit nr. *** prot., datë 2.7.2021.

⁶ Shkresa e KLP-së nr. *** prot., datë 8.7.2021.

- i. subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin e prokurorit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë;
- ii. procesi i rivlerësimit ndaj saj nuk ka përfunduar me vendim sipas pikës 1 të nenit 58 dhe me një nga masat disiplinore respektive sipas nenit 59, “konfirmimi në detyrë”, të nenit 60, “pezullimi nga detyra dhe detyrimi për të ndjekur programin e trajnimit” dhe të nenit 61, “shkarkimi nga detyra”;
- iii. subjekti i rivlerësimit, Anila Galanxhi (Pappa), ka ushtruar të drejtën për të dhënë dorëheqjen.
- iv. Këshillit i Lartë i Prokurorisë, me vendimin nr. ***, datë 18.6.2021, ka vendosur deklarinimin e mbarimit të statusit të magjistratit të znj. Anila Galanxhi (Pappa), për shkak të dorëheqjes.

31. Neni 65 i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar procedurën që duhet ndjekur për mbarimin e statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes⁷.

32. Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon: *“1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet. 2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”*.

33. Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 43, ka interpretuar, ndër të tjera, lidhjen ndërmjet këtyre dy dispozitave, si vijon: *“[...] Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që dorëhiqet brenda afatit 3-mujor, të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të këtij afati. Gjykata thekson se, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës [...]”*.

34. Për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e së drejtës së subjektit për t’u dëgjuar, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në rrugë elektronike, më 12.7.2021 ka njoftuar subjektin, meqenëse nga KLP-ja është konfirmuar dorëheqja e saj me vendimin nr. ***, datë 18.6.2021, nëse ka vullnetin të marrë pjesë në seancë dëgjimore dhe se fokusi i kësaj seance do të jetë përfundimi i procesit të rivlerësimit në zbatim të nenit G, paragrafi 1 dhe 2 i Aneksit të Kushtetutës.

35. Subjekti i rivlerësimit, më 13.7.2021, me anë të postës elektronike, ka njoftuar Komisionin se heq dorë nga e drejta për të marrë pjesë në seancën dëgjimore, konfirmon se nuk dëshiron të marrë pjesë në seancë dëgjimore dhe se në mbështetje të pikës 1 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës kërkon përfundimin e procesit të rivlerësimit për shkak dorëheqjeje.

⁷ 1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit.

36. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njeh Kushtetuta dhe ligji, për dorëheqje nga statusi i magjistratit. Ndërprerja e procesit të rivlerësimit, për shkak të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 57 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe në nenin 64 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

V E N D O S I:

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Anila Galanxhi (Pappa).
2. Ndalimin e emërimit të znj. Anila Galanxhi (Pappa) si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë e Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerëve Publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 13.7.2021

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda Bekteshi
Kryesuese

Etleda Çiftja
Anëtare

Olsi Komici
Relator

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj